



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.1000/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit *I.H.*, nga Peja, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.362/21, të datës 23.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.10.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, e sipas detyrës zyrtare, **ndryshohet** aktgjyqimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.362/21, të datës 23.06.2021, sipas të cilit i akuzuari *I.H.*, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, dhe kundër të akuzuarit *I.H.*, refuzohet aktakuza në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPK, pasi që ka kaluar afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale dhe ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale, ashtu që në kuptim të nenit 106 par.1 nën par.1.5, lidhur me nenin 107 par.8 të KPK, pasi që ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Pasi që aktgjyqimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar sipas detyrës zyrtare, ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, tani për tani është jo lëndore.

Shpenzimet e procedurës penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara K..., për realizmin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.362/21, të datës 23.06.2021, është liruar nga akuza i akuzuari *I.H*, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, për shkak se nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1016/2021, të datës 03.08.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtojë shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 të KPPK gjeti se:

- me rastin e ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti detyrimisht duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në pjesët për të cilat është ushtruar ankesa, dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se me aktgjykimin e kundërshtuar në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Nga aktgjykimi i ankimuar, rezulton se i akuzuari *I.H*, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPK, e cila vepër penale pretendohet të jetë kryer më dt.14.08.2015, për të cilën i akuzuari po qese shpallet fajtor mund ti shqiptohet dënimi me gjobë dhe burgim deri në 3(tre)vite.

Sipas ligjit të aplikueshëm, në kohën e kryerjes së veprës penale, për të cilën i akuzuari akuzohet, nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale është kryer me dt.14.08.2015, ashtu që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë për ndjekje penale në kuptim 106 par.1 nën par.1.5, lidhur me nenin 107 par.8 të KPK, ashtu që deri në mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj gjykate, kanë kaluar më shumë se 6(gjashtë)vite, çka do të thotë se në rastin konkret kundër të akuzuarit, për veprat penale për të cilat është akuzuar, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, andaj, në këtë çështje penale nuk mund të zhvillohet procedurë e mëtejme.

Meqë, në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin absolut, aktgjykimi i kundërshtuar detyrimisht ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç ‘arsye ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, tani për tani është jo lëndore.

Shpenzimet e procedurës penale konform nenit 454 par.1 të KPPK, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1000/2021, datë 04.10.2021

Sekretare juridike
Fitnete Hoti

Anëtares e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri